



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 10.09.2021 ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. Kompanisë “Industria Film”, të cilën e përfaqëson Artan Korenica, në tekstin vijues “Industria Film”

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim promovimin e vlerave kulturore dhe tradicionale të Komunës së Gjakovës, përfshirë Urën e Terezive, lumin Drin, Shkugëzën, lumin Krena, e shumë vende tjera kulturore – artistike përmes videoklipit - projektit të këngëtares Flaka Goranci me titull “Vendi Im”.

**Neni 2  
Obligimet e Komunës**

**2.1** Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 4,000.00 euro për realizimin e videoklipit - projektit të këngëtares me titull “Vendi Im” nga Flaka Goranci, për promovimin e vlerave kulturore – artistike të Komunës së Gjakovës.

**2.2** Mjetet që do të ndahen për realizimin e videoklipit të promovimin të vlerave kulturore – artistike të Komunës së Gjakovës, do të ekzekutohen pas pranimit të faturave e arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të janë të argumentuara nga kompania “Industria Film”.

**2.3.** Mjetet në vlerë prej 4,000.00 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime e Zyrës së Kryetarit të Komunës.



**Neni 3**  
**Obligimet e "Industria Film".**

**3.1** Obligohet të sjellë faturat, origjinal, arsyeshmërítë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e tyre.

**3.2** Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

**Neni 4**

Pjesë përbërëse e këtij memorandumi me të gjitha specifikat përcjellës eshtë kërkesa e Kompanisë "Industria Film" e përfaqësuar nga Artan Korenica.

**Neni 5**

**6.1.** Ky memorandum i bashkëpunimit eshtë i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëtin do ta zbatojnë në përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

**P A L Ë T**

**Komuna e Gjakovës**



**Ardian Gjini**

**"Industria Film"**

**Artan Korenica**